- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☒ Nuk i keni përbushur kërkesat formale/administrative
- ☐ Nuk i keni përbushur kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

☐ Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]-N/A

☐ Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Në dosje të tenderit tek Fleta e të dhënave të Tenderit (FDT) në nenin 5.5 Kushtet dhe kërkesat e dërgesës është kërkuar që:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin për kryerjen e hartimit të projekteve ideore dhe ekzekutive sipas specifikave teknike të kërkuara në dosjen e tenderit.

Afati i hartimit të projekteve ideore dhe ekzekutive nuk duhet të jetë më i gjatë se njëzetë (20) ditë nga data e marrjes së kërkesës nga Autoriteti Kontraktues.

Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do ti refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik

Ju si O.E keni dorëzuar afat kohor për ekzekutimin e kontratës deri më 36 muaj, por nuk keni dorëzuar – Afatin kohor për hartimin e projekteve ideore dhe ekzekutive i cili është dashur të jetë jo më i gjatë se 20 (njëzet) ditë, ku në DT është përcaktuar qartë se në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do ti refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik .

Lëshimi i cekur më lart ka bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Gazmend Gashi

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



Me 15.06.2023
Mamushë

Nr. i referencës: 626-23-005-2-2-1

Në bazë të nenit 62 dhe nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (h) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 bie këtë :

V E N D I M

I

Anulohet njoftimi B58 i datës 18.04.2023 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-23-1710-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-23-005-2-2-1 me titull: “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026”

II

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-23-1710-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-23-005-2-2-1

III

I njëjti do të rishpallet sipas procedurave të prokurimit, pas afatit për ankesa.

IV

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 09.03.2023 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026” me nr. të prokurimit: 626-23-1710-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-005-2-2-1. Pas njoftimit për kontratë dosjen e tenderit e kanë shkarkuar tridhjetë (30) Operatorë Ekonomik, ndërsa tenderin e kanë dorëzuar gjashtë (6) prej tyre.

Pas vlerësimit të tenderit në fjalë Me datën **18.04.2023** kemi publikuar njoftimin B58 për dhënie të kontratës grupit të O.E. “Geo-Group” SH.P.K. & “Enggroup” SH.P.K.


Të pa kënaqur me vendimin e AK-s Grup i Operatorëve Ekonomik Arhiko .ING O.P.; Lekaj.ING SH.P.K. me datën **19.04.2023** kanë paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-s. Pas shqyrtimit të kërkesës me vendimin **02 nr. 078-23** i është refuzuar kërkesa si pa bazuar.

Të pa kënaqur me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim Grup i Operatorëve Ekonomik Arhiko .ING O.P.; Lekaj.ING SH.P.K. me datën **02.05.2023** kanë paraqitur ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Pas shqyrtimit të ankesës, Paneli Shqyrtues i OSHP-s me vendimin **OSHP: 2023/0246** të datës **12.06.2023** ka vendosur që të anulojë procedurën e prokurimit në fjalë.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (h) të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës





Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0246

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetaria e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi - Kryetar ---- duke vendosur sipas ankesës së OE Arhiko .ING O.P., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026” me numër të prokurimit 626-23-1710-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E MAMUSHËS, më 12/06/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Anulohet** aktiviteti i prokurimit “HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE DHE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS PËR VITET 2023-2026”, me numër të prokurimit 626-23-1710-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E MAMUSHËS.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 09.03.2023, Komuna e Mamushes, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve ideore dhe ekzekutive te Komunes se Mamushes per vitet 2023-2026 ” me nr. të prokurimit: "626-23-1710-

2-2-1". Nderkaq me datën 18.04.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE "Arhiko.ING O.P" shpk me datën 19. 04. 2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 25. 04. 2023, AK- KK Mamushe me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Arhiko.ING O.P", me datën 02.05.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 246/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 20.000.00€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 14.05.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si pjeserisht e bazuar
- të anulohet në tërësi ky aktivitet i prokurimi

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Pretendimi nr.1

Pretendimi ankomor OE ankues: "Me datë 18.04.2023 kemi pranuar nga AK Komuna e Mamushës letrën standarde për tenderuesin e eliminuar me te cilin jemi njoftuar se OE Arhiko.ing është konsideruar OE i papërgjegjshëm dhe jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin që nuk e kemi përmbushur kriterin në dosjen e tenderit pika 5.5. Lloji i Kontratës, Kërkesat dhe Kushtet e Dërgesës, Kushtet e Kontratës. Kunder këtij vendimi ne kemi parashtruar kerkese per rishqyrtim ne AK Komuna e Mamushës ku ky i fundit ka marre vendimin e dates 25.04.2023 me te cilin ka refuzuar kerkesen tone si te pabazuar. Ne konsiderojme se vendimi i dates 18.04.2023 nga ana e AK-ë është tërësishtë i pabazuar pasi që ne nuk e shofim si kriter të përzgjedhjes për shperblimin me kontratë këtë pike siç është parapare nga ana e AK-së ku vet fakti që kërkesa e renditur në kolonën "udhëzimet për tenderuesin" pika 5.5(Lloji i Kontratës, Kërkesat dhe Kushtet e Dërgesës, Kushtet e Kontratës) konsiderojmë që

kjo kerkese plotësohet pas nënshkrimit të kontratës meq edhe kërkesa që është përpiluar në dosjen e tenderit nuk i përket kërkesave të pranueshmeria e OE apo kërkesat e përshtatshmerisë në dosjen e tenderit, kërkesa këto që ne i jemi përmbajt dhe kemi plotësuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga ana e AK-së përcaktohen sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi”.

Përgjigje Pretendimit ankimor:

Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor, dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit në platformën e-prokurimit përkatësisht pretendimit të OE ankues, sqaron se, AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, perkatesisht të Lloji i Kontratës, Kërkesat dhe Kushtet e Dërgesës, Kushtet e Kontratës, pika 5.5 e dosjes së tenderit, ka përcaktuar si në vijim:

“Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin për kryerjen e hartimit të projekteve ideore dhe ekzekutive sipas specifikave teknike të kërkuara në dosjen e tenderit.

Afati i hartimit të projekteve ideore dhe ekzekutive nuk duhet të jetë më i gjatë se njëzetë (20) ditë nga data e marrjes së kërkesës nga Autoriteti Kontraktues.

Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik”.

Fillimisht, Eksperti Shqyrtues sqaron se, “Plani Dinamik” është kusht administrativ dhe kusht i kontratës. Si rrejdhojë nuk është kërkesë e neneve 65-71 për të cilat mund të kërkohet sqarime shtesë, prandaj gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në rast se “Plani Dinamik” mungon, nuk mund të kërkohet informacion të mëtejshëm nga OE në bazë të nenit 72 të LPP-së dhe as sipas paragrafit 2 të nenit 59 të LPP-së.

Megjithatë, duke u bazuar në kërkesën e lartë cituar të vendosur nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit, konkretisht të pika 5.5 e dosjes së tenderit, “Lloji i Kontratës, Kërkesat dhe Kushtet e Dërgesës, Kushtet e Kontratës”, Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë, konsideron se, sipas përshkrimit në pikën 5.5 të dosjes së tenderit, përveçse është kërkesë e pa qartë, sipas kësaj kërkesë është vështirë të bëhet vlerësimi i drejtë i tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu, konsideroj se, është kërkesë kufizuese për Operatorë Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, për faktin se, të bëhet “hartimi i projekteve ideore dhe ekzekutive brenda 20 ditëve”, është kohë e shkurtë duke pas parasysh natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit.

Sqarim:

Në Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58), të datës 18.04.2023, AK me Lertat Standarde ka njoftuar Operatorët Ekonomik pjesëmarrës lidhur me rezultatin e aktivitet të prokurimit me titull: “Hartimi i Projekteve Ideore dhe Ekzekutive të Komunës së Mamushës për Vitet 2023-2026”, me numër të prokurimit: 626-23-1710-2-2-1”.

Nga gjashtë (6) OE të cilet kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit, të gjithë OE-ve pjesëmarrës në arsyetimin e dhënë nga AK në Lertat Standarde, një nga arsyet e eliminimit është sipas kërkesës në pikën 5.5 e dosjes së tenderit, përveç Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë i cili ka bashkangjitur në ofertën e tij planin dinamik.

Eksperti shqyrtues konsideron se, sipas sqarimeve të lartpërmendura, pika 5.5 e dosjes së tenderit e përcaktuar nga AK ka qenë e pa qartë, si rrjedhojë sipas këtij përshkrimi është vështirë të bëhet vlerësimi, krahasimi dhe ekzaminimi i tenderve. Andaj, pretendimi i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankomor OE ankues: "gjate qasjes në dokumenta zyrtare kemi hasur në një sigurim komplet tjetër nga ai që është dorëzuar gjatë ofertimit, ndryshimi vërehet duke filluar nga lloji i shkrimit, pozicioni i titullit, nënshkrimi, vula, distanca e shkronjave ku këtu lindin dyshimet për ndryshime në dokumentin e dorëzuar dhe atë fizik që kemi parë në qasje.

Ne e kemi të paqartë se si janë paraqitur dy sigurime të tenderit komplet ndryshe nga njëri tjetër. Ne e kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues edhe sqarimin e paraqitur nga kompania e sigurimeve, mirepo nuk është sqaruar një gjë se si është e mundur që për të njëjtin tender të paraqiten dy sigurime komplet të ndryshme dhe si të tillë Autoriteti Kontraktues është dashur të shpallet GOE në fjalë si GOE i papërgjigjshëm".

Përgjigje Pretendimit ankimor:

Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit në platformën e-prokurimit, përkatësisht pretendimit të OE ankues, gjithashtu ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, sqaron si në vijim:

AK në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE ankues lidhur me këtë pretendim ankimor, AK ka potencuar se, "Pasi kemi pranuar njoftimin e OE ankues se sigurimi i skanuar që është dorëzuar me dosje të tenderit dhe sigurimi original i dorëzuar nga OE i rekomanduar janë të ndryshëm, ne kemi kërkuar sqarim me shkrim nga kompania e sigurimeve "Elsig" e cila e ka leshuar policën e sigurimit me nr 111814 në mënyrë që të na sqaron se si ka ndodhur që polica e sigurimit të leshohet me nr të njëjta dhe të dhëna të njëjta, ndërsa nënshkrimi në policën e dorëzuar fizikisht, është i ndryshëm nga ai i skanuar dhe i dorëzuar me ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë.

Me datën 20.04.2023 kemi pranuar përgjigjen nga kompania e sigurimeve "Elsig" se: Sigrinli i garancisë së tenderit me nr. 111814 është leshuar nga K.S. "Elsig sh.a. dhe e njëjta ka shumë sigurimi 1,000.00€ dhe se ky garancion ka mbulesë siguruese nga dt. 30.03.2023 deri me datën 28.06.2023. andaj konsiderojmë që sigurimi i tenderit i plotëson kushtet e kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe sipas formës standarde e cila është pjesë e dosjes së tenderit, sepse i përmban të gjitha elementet. Ndërsa pretendimi që është shkelur nëni 10 i Udhëzuesit të Prokurimit nr. 01/2023 është i pa baze pasi që polica e sigurimit i përmban të gjitha pjesët e kërkuara në aneksin nr. 4 të dosjes së tenderit".

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim të OE ankues, sqaron se:

Për Sigurimin e Tenderit flet nëni 57 i LPP-së dhe nëni 28 i Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP).

Sipas nënit 28.2 dhe nënit 28.3 të RRPP, Sigurimi i tenderit është opsional që nënkupton që në rast të kontratave me vlerë të madhe dhe të mesme AK mund të imponoj kërkesën e sigurimit të tenderit.

Nëse AK imponon kërkesën e sigurimit të tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit dhe kushtet do të parashtrihen në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë.


Ndërsa,

Nëni 28.13 i Rregullores për Prokurimin Publik, përcakton: "Sigurimi i tenderit duhet të dorëzohet i skanuar së bashku me ofertë, ndërsa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohej të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Mos dorëzimi i formës

originale të sigurimit të tenderit shpije në zbatimin e nenit 99.2 të LPP-së”.

Pra, duke qenë se, OE i rekomanduar për kontratë Sigurimin e Tenderit e ka dorëzuar fizikisht të ndryshem nga ai i skanuar në ofertë, konsideroj se, sipas dispozites së lartë cituar, Sigurimi i tenderit i cili është dorëzohet i skanuar se bashku me ofertë edhe forma origjinale e njejtë e sigurimit të tenderit do të duhej të dorëzohet nga tenderuesi të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë . Andaj, pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.

Provë:



Pretendimi ankomor OE ankues: . Sa i përket stafit profesional pasiqe ishte sekret afarist, ne dyshojm qe GOE nuk e kan permbushur kerkesen ne piken 9.1 dhe 9.2 duke ofruar gjithesej stafin e kompletuar siq eshte kerkuar nga AK. 6/3 Ne pretendojme qe stafi si:

- minimumi dhjetë (10) punëtorë ndër të cilët minimum
- Një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv min. 5 vite përvoja pune
- Një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë drejtimi hidro përvoja minimale min. 2 vite.
- Një inxhinier të arkitekturës (ose bachelor),
- Një inxhinier të elektroteknikës dhe
- Një inxhinier të gjeodezisë min. Shkolla e mesme.

Përgjigje Pretendimit ankimor:

Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor, dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit në platformën e-prokurimit përkatësisht pretendimit të OE ankues, gjithashtu ofertës së OE të rekomanruar për kontratë, Eksperti Shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë i ploteson kërkesat e pikës 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. **Pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar.**

Eksperti Shqyrtues i prokurimit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, po ashtu duke u bazuar në faktet dhe sqarimet e lartpërmendura, i propozon AK- KOMUNA E MAMUSHËS, që këtë procedurë të prokurimit ta anuloi në tërësi dhe në rast të ri tenderimit, të veproj në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionit dytësor që kriteret, kushtet, kërkesat dëshmitë dhe specifikimet në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ti specifikojnë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për Operatorët Ekonomik.

Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë.

Sipas nenit 17.12 të Rregullores për Prokurimin Publik, citoj: "Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjalë në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasyshë, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike. në rast se AK organizon vizite në vendpunishte apo konference para-ofertuese, pjesëmarrja e OE në vizite në vend-punishte/konference para-ofertuese nuk duhet të jete obligative. Vizita në vend-punishte/konference para-ofertuese organizohet për OE dhe është

në të mirën e tyre, pra është ndihmese për OE”.

Gjithashtu, duke qenë se Rregullorja për Prokurimin Publik, e cila ka hy në fuqi me datë 01.11.2022, lidhur me kontratat kornizë kur AK nuk dinë sasi të indikative, AK gjatë hartimit të dosjes duhet ta specifikojë në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë informatat lidhur me nenin 54.15 të Rregullores për Prokurimin Publik, e cila përcakton si në vijim:

“54.15 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktojë peshët në baze të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktojë se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shumë fikse. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje)”.

Eksperti Shqyrtues i prokurimit, duke u bazuar në faktet dhe sqarimet e lartpërmendura, i propozon AK- KOMUNA E MAMUSHËS, që këtë procedurë të prokurimit ta anuloi në tërësi dhe në rast të ri tenderimit, të veprojë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionit dytësor, që kriteret, kushtet, kërkesat dëshmitë dhe specifikimet në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë të specifikojnë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për Operatorët Ekonomik.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - KOMUNA E MAMUSHËS
- OE - Arhiko .ING O.P.
- Arkivës së OSHP-së: